

## Dhoma e Biznesit të Diasporës

Rr. "Ibrahim Rugova", Sky Tower, 13/3, Tiranë  
K.P. 1001, Tiranë-Shqipëri

[www.adbc.al](http://www.adbc.al)

e-mail: [info@adbc.al](mailto:info@adbc.al)

## Shoqata Italiane e Kultivuesve

Associazione Italiana Coltivatori (AIC)

Via Torino 95, 00187 Roma-Italia

<https://www.aicznazionale.com/>

Email: [info@aicnazionale.com](mailto:info@aicnazionale.com)



# Angazhimi i Diasporës në transferimin e njohurive bujqësore në Shqipëri

Broshura nr. 4, korrik 2021

Mundësuar nga :



*Informacioni dhe pikëpamjet e shprehura në këtë broshurë nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht pikëpamjet dhe qëndrimet e IOM Albania.*



[www.diasporanameson.al](http://www.diasporanameson.al)

# BUJQËSIA

## *E ardhmja janë standardet*

Bujqësia dhe tërësia e prodhimit të këtij sektori bën pjesë në Planin për Integrim Evropian dhe në Planin e Veprimit për Zbatimin e Partneritetit Evropian (2010-2014). Të gjithë aktorët e sektorit të bujqësisë dhe blegtorisë duhet të vlerësojnë me seriozitet dhe të angazhohen e të orientohen drejt sigurimit të një zhvillimi të qëndrueshëm në të gjithë zinxhirin e aktivitetit të tyre me qëllim rritjen optimale të prodhimit për plotësimin sa më mirë të nevojave dhe kërkesave të tregut të brendshëm duke ndikuar drejtpërdrejt në zvogëlimin e importit dhe rritjen e mundësive për eksport si edhe ruajtjen dhe konsolidimin e këtij zhvillimi. Nën sektori i fruta/perimeve zotëron asete dhe kapacitete njerëzore të konsiderueshme për tu përfshirë potencialisht në zhvillimin e qëndrueshëm duke bërë të mundur zbatimin e teknologjive miqësore në bujqësi, Praktikën e Mirë Bujqësore (GAP), praktikën e pas-vjeljes, si edhe krijimin e bashkëpunimeve ndërmjet prodhuesve bujqësorë drejt organizimit në një cikël të plotë prodhim-grumbullim-tregtim të produkteve të tyre. Ky nën sektor është i ekspozuar drejtpërdrejt ndaj shijes dhe kërkesës së konsumatorit e cila tashmë është e përcaktuar drejt produkteve organike, të sigurtë e të shëndetshme dhe gjysmë të gatshme. Konkurrenca që përcakton ky zhvillim i hap rrugë përmirësimit të gjithë eco-sistemit të bujqësisë, nga mirëmbajtja e tokës, bimësisë perimo/frutore, zvogëlimin të ndotjeve dhe riciklimit të tyre, shfrytëzimit të sipërfaqeve, përqafimit të teknologjive të avancuara, ngritjen e nivelit të punësimit, ndërtimin e strukturave bashkëkohore për grumbullim dhe ruajtje, përdorimin e mjeteve të duhura, futjen e teknologjive eficientë në trajtim dhe përpunim, zgjedhjen e materialeve ekologjike në paketim etj

### **Pasqyrimi i standardizimit dhe certifikimit në legjislacion**

- Ligji Nr. 9199, datë 26/02/2004 “Për prodhimin, përpunimin, certifikimin dhe tregtimin e produkteve “Bio”



Global G.A.P është një standart ndërkombëtar që ofron një sërë lehtësish në shpërndarje dhe shitje për fermerët dhe agrobizneset. Përmes këtij certifikimi fermerët dhe agrobizneset mund të vërtetojnë se prodhimet e tyre janë të sigurtë,

cilësore dhe në koherencë me standartet e ligjet Evropiane. Rrjeti Global G.A.P përfshin më shumë se 2000 inspektorë që veprojnë në mbarë botën me certifikime dhe numëron më shumë se 200 mijë prodhues të certifikuar me këtë standart.

### **Përse duhet certifikimi Global G.A.P?**

Duke certifikuar produktet me standardin Global G.A.P, fermerët Shqiptarë kanë më shumë mundësi të lidhin kontrata afatgjata me grumbulluesit në vend dhe me blerës të mëdhenj jashtë vendit duke siguruar kështu më shumë shitje dhe eksporte, ekspozim të produkteve dhe kompanive vendase në tregje të zhvilluara e me vlerë të lartë. Agrobizneset pas certifikimit me Global G.A.P fitojnë besueshmëri tek tregjet e huaja dhe mund të eksportojnë prodhimet e tyre në Bashkimin Evropian me çmime konkurruese. Fushat ku zbatohet standardi GlobalGAP janë prodhimet bujqësore, produktet blegtorale dhe akuakulturën.

**Standardet kryesore të GlobalGAP janë:**

- Standardi GlobalGAP i frutave dhe perimeve
- Bimë GlobalGAP lulesh dhe bimësh zbukuruese
- Standardet e kulturave të fushës GlobalGAP
- Standardi GlobalGAP kafe të gjelbër
- Standardi i çajit GlobalGAP
- Standardi i akuakultures aquaGPG
- Standardi GlobalGAP i blegtorisë (standardi i mbarështimit të gjedhit dhe deleve, standard i shpendëve)
- Standardi i ushqyerjes së kompleksit GlobalGAP

# HACCP

H.A.C.C.P është një sistem menaxhimi i cili lejon identifikimin dhe vlerësimin e rreziqeve potenciale në të gjitha fazat e prodhimit dhe përpunimit të produkteve ushqimore. Ky sistem ofron sigurinë e ushqimit në të gjitha hallkat e zinxhirit ushqimor. Parimet HACCP janë pjesë e Direktivave Europiane dhe e Legjislacionit Shqipëtar të Ushqimit, implementimi i të cilave është kërkesë ligjore për të gjithë operatorët e industrisë ushqimore.



Bujqësia organike është një sistem me nivelin më të lartë të besueshmërisë dhe gjurmueshmërinë midis sistemeve të prodhimit bujqësor që aplikohet duke kontrolluar dhe certifikuar të gjitha fazat e prodhimit nga fusha në tryezë.



Standardi kryesor për produktet bujqësore në Shtetet e Bashkuara të Amerikës USDA. NOP - Programi Kombëtar Organik për certifikimin organik sipas Standardeve të Programit Kombëtar Organik.



Aplikimi i mënyrave, metodave dhe teknikave të miratuara të përfitimit dhe përpunimit të produkteve, kryesisht blegtorale krahas respektimit rigoroz të rregullave përjashtimore për përfshirjen e substancave dhe përbërësve specifikë.

Ky ligj synon nxitjen e prodhimit organik në Shqipëri, krijimin e kuadrit ligjor të nevojshëm dhe përcaktimin e kushteve të prodhimit, përpunimit, transportit, certifikimit dhe kontrollit të produkteve bujqësore dhe atyre ushqimore me prejardhje bimore ose shtazore, që prodhohen, përpunohen ose/dhe importohen e tregtohen si produkte “Bio”. Ligji rregullon ngritjen e Komisionit Shtetëror të Prodhimit Organik (KSHPO), përcakton kushtet specifike të prodhimit organik, jep leje të përkohshme për përdorimin e materialeve të palistuar në Anekse, përcakton kushtet për etiketimin e produkteve “Bio”, procedurat e kundërvajtjeve administrative si dhe sanksionet që ndërmerren për to. Pyetësorët e Bujqësisë Organike janë integruar në sistemin e regjistrimit të fermës, të dhënat e të cilit mbledhen dhe përpunohen dhe nga INSTAT.

- Ligj Nr. 106/2016 “Për Prodhimin Biologjik, Etiketimin e Produkteve Biologjike dhe Kontrollin e Tyre”

Qëllimi i këtij ligji është të krijojë bazën për zhvillimin e qëndrueshëm të prodhimit biologjik, të sigurojë funksionimin efikas të tregut dhe të garantojë konkurrencë të drejtë, besimin dhe mbrojtjen e interesave të konsumatorëve. Ligji përcakton objektivat dhe parimet e përgjithshme për: a) të gjitha fazat e prodhimit, përgatitjes e shpërndarjes së produkteve biologjike dhe kontrollit të tyre; b) përdorimin e treguesve që i referohen prodhimit biologjik në etiketim dhe reklama.

Në bazë të nenit 4 të Ligjit 9199/2004 për bujqësinë organike, organizma certifikues vendas dhe të huaj lejohen të ushtrojnë aktivitetet certifikues për feramat dhe operatorët që veprojnë në bujqësinë organike. Këta organizma duhet që më parë të jenë akredituar. Akreditimi i organizmave certifikues kryhet nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit (DPA), e cila është një organizëm kombëtar i akreditimit, i njohur nga qeveria për të vlerësuar në përputhje me standardet ndërkombëtare kompetencën teknike të organizmave të vlerësimit të përputhshmërisë.

DPA operon në përputhje me Ligjin Nr. 9824, datë 01/11/2007, “Për Akreditimin e organizmave të vlerësimit të konformitetit në RSH” dhe akreditimi nga DPA kryhet në përputhje me standardet ndërkombëtare të vendosura nga Organizata Ndërkombëtare e Standardizimit (ISO).

## Entet publike të përfshira në procedurat e certifikimit

Komisionit Shtetëror të Prodhimit Organik (KSHPO), është organi shtetëror përgjegjës për zbatimin dhe administrimin e legjislacionit dhe sistemit të bujqësisë organike në Shqipëri. KSHPO kryen:

- njohjen së organizmave certifikues dhe inspektorëve të prodhimit organik;
- regjistrimin të kërkesave të fermerëve për aplikim për tu futur në sistemin e prodhimit organik;
- mbikëqyrjen të aktivitetit vjetor të organizmave certifikues;
- regjistrimit të njësive të prodhimit organik pas miratimit nga organizmi certifikues i zgjedhur nga vetë ferma;
- publikimin e përditësuar të listës së emrave dhe adresave të njësive të prodhimit, përpunimit dhe tregtimit të produkteve “Bio”;
- regjistrimin e subjekteve vendase dhe të huaja që eksportojnë dhe importojnë produkte “Bio”;
- pajisjen e këtyre subjekteve me certifikatë që vlen vetëm për rastin e shqyrtuar;
- publikon logon e organizmave certifikues;
- organizon kualifikimin dhe testimin e përvitshëm të inspektorëve;
- propozon modelet e formularëve që njësitë prodhuese, organizmat certifikues dhe subjektet import/eksport duhet të plotësojnë;
- paraqet vendimet e marra për pranimin e veprimtarisë apo ndërprerjen e kontratave të bashkëpunimit për organizmat certifikues dhe inspektorët si vendas dhe të huaj;
- jep autorizim të përkohshëm për:
  - a) përdorimin e materialeve të palistuar në anekset II e III të këtij ligji përdorimin e materialeve me origjinë jobujqësore (ndihmesat teknologjike dhe shtesat) ose me origjinë bujqësore joorganike për përpunim, të palistuar në shkronjën “D” dhe “E” të aneksit II.



**Control Union Certifications B.V.**

Netherlands Postbus 161 8000 AD ZWOLLE C  
Website: <https://certifications.controlunion.com/en>

**IMO INST FUR MARKT COLOGIE CH**  
**IMO Institute**  
**for Marketecology**

Adresa: Weststrasse 51, Weinfelden Switzerland CH-8570  
Tel: +414106260626  
E-mail: [www.aaa-consultancy.net](http://www.aaa-consultancy.net)



**ECOCERT**  
Adresa: BP 47 F-32600 L'Isle Jourdain, France  
Tel: +33 (0)5 62 07 66 13 Fax: +33 (0)5 62 07 66 19  
E-mail: [office.international@ecocert.com](mailto:office.international@ecocert.com)

**Istituto Mediterraneo di Certificazione**  
**IMC srl - Itali**

Adresa: Via Pisacane 53 I-60019 Senigallia (AN)  
Tel: +39 (0)71/7928725/7930179 Fax: +39 (0)71/7910043  
E-mail: [imcert@imcert.it](mailto:imcert@imcert.it) Web site: [www.imcert.it](http://www.imcert.it)





### **CERES GmbH -Gjermani**

Kontakt: Vorderhaslach 1 91230 Happurg

Tel: +49 9158 928290 Fax: +49 9158 9289862

E-mail: [info@ceres-cert.com](mailto:info@ceres-cert.com) Web site: [www.ceres-cert.com](http://www.ceres-cert.com)

### **BCS ko-Garantie GmbH Control System Peter Grosch – Gjermani**

Adresa: Cimbernstrasse 21 D-90402 Nurnberg

Tel: +49 (0)911/424390 Fax: +49 (0)911/492239

E-Mail: [info@bcs-oeko.de](mailto:info@bcs-oeko.de)

Website: <http://www.bcs-oeko.de>



### **BioInspecta AG**

Ackerstrasse 117, 5070 Frick, Switzerland

Tel. +41 (0) 62 865 63 00

[info@bio-inspecta.ch](mailto:info@bio-inspecta.ch)

Standardi NOP-USDA

**Enti Shtetëror i Farave dhe Fidanëve (ESHFF)**, siguron pastërtinë e rregullat e prodhimit, certifikimit, regjistrimit dhe tregtimit të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor, përfshirë dhe atë organik me laborator reference të integruar. (Lista e shërbimeve të Entit Shtetëror i Farave dhe Fidanëve <https://www.adisa.gov.al/lista-e-sherbimeve-eshff/>)

**Agjencia e Kontrollit të Ushqimit (AKU)** menaxhon kontrollin e materialit mbjellës dhe shumëzues bimor, përfshirë dhe atë organik, në treg, dogana, pika grumbullimi/ruajtje, etj., për sigurimin e respektimit të rregullave të tregtimit dhe pastërtisë fitosanitare të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor/organik. AKU gjithashtu kryen kontrole për vlerësimin e cilësisë së plehrave, përpara hedhjes së tyre në treg dhe gjatë tregtimit, për të garantuar mbrojtjen e jetës, shëndetit dhe mjedisit si dhe interesat ekonomike të fermerëve, si rregulla thelbësore të prodhimit organik (website: <https://aku.gov.al/> Lista e shërbimeve të AKU <https://www.adisa.gov.al/lista-e-sherbimeve-aku/>)

**Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë (ISUV)** është Qendër Reference në kontrollin e sigurisë dhe cilësisë së ushqimeve, përfshirë atë organik (website: <http://www.isuv.gov.al/en/>)

**Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore QTTB-Fushë Krujë** ka të integruar laboratorin e referencave për analizën e tokave (mbetjet toksike apo të lëndëve të tjera të papranueshme për prodhimin organik). Ky laborator përveç sa më sipër, kryen analiza për ujërat dhe plehrat që përdoren në bimësi. (<http://www.qttbfushekruje.gov.al/about.html>)

**Universiteti Bujqësor Tiranë (UBT)**, nëpërmjet Departamentit të Mbrojtjes së Bimëve ndihmon në analizimin e dëmtuesve dhe sëmundjeve për realizimin me sukses të luftës së integruar në këtë drejtim (IPM ), aq e rëndësishme në prodhimin organik. Një rol po aq të rëndësishëm këtu, luan dhe Banka Gjenetike (UBT) për resurset gjenetike (<https://ubt.edu.al/sq/fakulteti-i-bujqesise-dhe-mjedisit/departamenti-i-mbrojtjes-se-bimeve-2/>)

## Trupat certifikues vendas dhe të huaj



Organizmi i inspektim/certifikimit Albinspekt, është operatori i parë, që siguron një shërbim inspektimi dhe certifikimi të produkteve

organike sipas Standardeve kombëtare, private

dhe Evropiane. Albinspekt është një shoqëri aksionere private, e njohur nga KSHPO, si organizëm certifikues në bazë të Ligjit shqiptar Nr. 9199/2004 për produktet “Bio” si dhe VKM Nr. 639, datë 14/05/2008 për regjistrimin e organizmave certifikues si dhe nga DPA në Shqipëri.

Albinspekt, gjithashtu, është akredituar gjatë vitit 2009 nga DGA (Deutsche Gesellschaft für Akkreditierung GmbH) sipas normës Evropiane EN 45011/1998, për kryerjen e shërbimit të certifikimit të produkteve organike në fushat e prodhimit bimor dhe shtazor dhe të përpunimit. Roli kryesor i Albinspekt është sigurimi i shërbimit të inspektim/certifikimit si dhe informacion lidhur me parimet dhe metodat e prodhimit organik.

Albinspekt ofron shërbimin e certifikimit Global GAP nëpërmjet bashkëpunimit me trupën tonë partnerë në Portugali – Sativa. Albinspekt është e vetmja trupë shqiptare që ofron shërbimin e inspektimit Global GAP me inspektorë lokale të njohur nga Food Plus për kryerjen e inspektimeve dhe auditimeve sipas Opsionit 1 (individual) dhe Opsionit 2 (në grup).

Bazuar në listën e autoriteteve dhe organeve të kontrollit që veprojnë në vendet e treta apo që inspektojnë eksportuesit e përfshirë në importe nga vendet e treta ([https://www.globalgap.org/uk\\_en/what-we-do/the-gg-system/certification/Approved-CBs/index.html](https://www.globalgap.org/uk_en/what-we-do/the-gg-system/certification/Approved-CBs/index.html)), [https://apeda.gov.in/apedawebsite/organic/NPOP\\_certification\\_bodies.pdf](https://apeda.gov.in/apedawebsite/organic/NPOP_certification_bodies.pdf)

[https://ec.europa.eu/agriculture/ofis\\_public/actor\\_cbeu/ctrl.cfm?targetUrl=home](https://ec.europa.eu/agriculture/ofis_public/actor_cbeu/ctrl.cfm?targetUrl=home)) në Shqipëri, operojnë edhe organizma të huaj certifikimi që janë të njohur dhe akredituar për certifikim të produkteve “bio” në vendet e tyre të origjinës. Organizmat certifikues të huaj kryejnë certifikim në bazë të Rregullores Nr. 834/2007 të BE, për prodhimin dhe etiketimin e produkteve organike si dhe standardit amerikan për produktet organike (NOP)

### **Consorzio ICEA -Istituto per la Certificazione Etica e Ambientale**

(Instituti për Certifikimin e Etikës Mjedisore)

Kontakt: Strada Maggiore 29 I-40125 Bologna Tel: +39 (0)51/272986

Fax: +39 (0)51/232011

E-mail: [icea@icea.info](mailto:icea@icea.info)

<https://iceaalbania1.wordpress.com/>

